



MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Diskutim me komunitetin në Cyrih

Projektiligji për Diasporën dhe Projekt-Strategjia(2019-2023)

Përmbledhja e rekomandimeve

Cyrih, tetor 2018

© 2018 Germin

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Germin ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr."Tringë Smajli". Nr.48

10000 Prishtinë, Kosovë

E-mail: germinks@gmail.com

Web: www.diasporaflet.org | www.organizatashqiptare.org

Autor: GERMIN

Ky publikim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Germin, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Mirënjohje

Germin i është shumë falënderues pjesëmarrësve të takimit konsultues që kanë gjetur kohën për të marrë pjesë dhe për të shprehur rekomandimet, sfidat dhe kërkesat e diasporës ndaj projektligjit dhe projek-strategjisë për Diasporën. Ekipi i është gjithashtu mirënjohës *Shoqatës së studentëve shqiptarë "Studenti"* për mbështetjen e tyre në organizimin e këtij takimi.

Qëllimi i Raportit & Metodologjia

Takimi me diasporën shqiptare u organizua në Cyrih të Zvicrës nga Germin, organizatë joqeveritare e përqëndruar në Kosovë me fokus në hulumtimin e diasporës. Diskutimi u organizua si pjesë e projektit *Angazhimi i Diasporës për Zhvillimin e Politikave*. Qëllimi gjithëpërfshirës i këtij projekti është që të lehtësojë kontributin e Diasporës në Kosovë gjatë procesit të hartimit të politikave dhe strategjive, në veçanti të *Strategjisë së Diasporës (2019 -2023)*, *Planit të Veprimit (2019-2021)* dhe *Projektligjit për Diasporën* që tani është në konsultim me publikun.

Përmes kësaj nisme synohet:

- Avancimi i zërit të Diasporës në hartimin e politikave dhe strategjive me anë të forumeve dhe kanaleve të reja teknologjike;
- Të përfshihen aftësitë dhe njohuritë e pjesëtarëve të Diasporës që proceset gjatë zhvillimit të politikave dhe legjislacionit;
- Të fuqizohen pjesëtarët e shtatë task forcave të krijuara nga Germin për të marrë pjesë në proceset politikëbërëse në Kosovë.

Ky raport në nxjerrë në pah sfidat, kërkesat dhe rekomandimet kryesore të takimit me komunitetin, i mbajtur me 17 tetor 2018 në Cyrih, pjesë e aktivteteve të Germin në Diasporë në kuadër të nismës *Angazhimi i Diasporës për Zhvillimin e Politikave*.

Në takim prezent ishin 48 pjesëmarrës(33 burra dhe 15 gra) që përfaqësonin shoqata, grupe të profesionistëve, studentë, organizata dhe biznese të ndryshme nga Cyrihu, Solothurn, Spreitenbach, Winterthur, Schaffhausen, Münchenstein, Bernë, St.Gallen dhe Luzern. Takimi u organizua në tre pjesë, *Projektligjin për Diasporën* ishte dokumenti që u diskutua në pjesën e parë, në pjesën e dytë për *Projekt-Strategjia për Diasporën (2019-2023)*, për të vazhduar punën në *Planin e Veprimit(2019-2021)*. Pjesëmarrësit në këto tre pjesë të takimit patën mundësinë që drejtëpërdrejt të kalojnë rekomandimet e tyre në këto dokumente ku bëhet fjalë për zbatimin e të drejtave të tyre politike, socio-ekonomike dhe kulturore në vendin e origjinës.

Gjuha e përdorur përgjatë takimit ishte gjuha shqipe dhe të gjithë pjesëmarrësit identifikohen si shqiptarë, por diversiteti i tyre përfaqëson një sërë opinionesh, perspektivash dhe temash të identifikuar në këtë raport. Pjesëmarrësit në këtë takim përfaqësonin fusha dhe profesione të ndryshme (p.sh. arsim, inxhinieri, studentë, ekonomist, gazetar, përfaqësues shoqatave kulturore, politikan, përfaqësues biznesesh, etj.) të cilët janë me prejardhje nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia.

Rekomandimet kryesore të dalura nga takimi në Cyrih

Pas shumë diskutimesh në këtë takim dolën këto rekomandime që Ministria Diasporës dhe Investimeve Strategjike duhet t'i merr për bazë në përpilimin final të këtyre dokumenteve. Një nga kërkesat gjenerale të këtij takimi ishte që Projekt-Strategjia për Diasporën dhe Projekligji të harmonizohen me njëra tjetrën sa i përket terminologjisë së përdorur dhe të mbahet një përputhje në mes të këtyre dy dokumenteve.

Investimet strategjike

Me globalizmin në ditët e sotme, mallrat, kapitalet, njerëzit dhe idetë po qarkullojnë si kurrë më parë. Një ndër faktorët e rëndësishëm për rritjen e ekonomive të shteteve në zhvillim janë investimet nga jashtë.

Sot shumë anëtarë të diasporës shqiptare përfaqësojnë biznese, organizata të ndryshme ndërkombëtare, të cilët janë të gatshëm të investojnë prapa në vendin origjinës, si përmes bizneseve ashtu edhe transferit të dijes.

Kështu, Investimet strategjike janë një ndër prioritetet e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike për periudhën pesë vjeçare (2019-2023), përmes tërheqjes së investitorëve nga diaspora.

“Kur përmenden investimet strategjike atëherë mos të përmenden vetëm bizneset por edhe profesionistët që jetojnë jashtë vendit amë, nëse qëllimi është tek bizneset atëherë le të emërohet kjo pjesë e ligjit si Investimet ekonomike”.

“Krijimi i zyreve të veçanta për investime, të cilat nxisin ardhjen e investitorëve nga diaspora dhe investitorëve të tjerë ndërkombëtar dhe njëkohësisht rritjen e eksporteve drejt këtyre vendeve”.

“Të hyrat nga kartoni i gjelbër të kthehen në fond të investimeve, si për shkollat, fabrika, etj”.

“Të bëhet kanalizimi i të hollave të diasporës, duke krijuar një fond investiv i cili nuk menaxhohet nga ministria, mirëpo ministria ndihmon në krijimin dhe promovimin e tij, ndërsa menaxhimi të bëhet nga ndonjë bank”.

Ruajtja e identitetit

Ruajtja e identitetit që vazhdon të jetë një nga prioritetet për diasporën shqiptare, njëherit edhe e institucioneve përgjegjëse të shteteve amë, po përballet me shumë sfida. Edhe pse diaspora për shumë vite ka mbajtur gjallë identitetin përmes gjuhës, kulturës dhe traditave, me kalimin e viteve shohim se kjo gjë po zbehet gradualisht. Një ndër akterët kryesor për ruajtjen e identitetit është ruajtja e gjuhës amtare dhe përcjellja e saj tek gjeneratat e reja. Gjuha është një tregues i rëndësishëm i identitetit tonë që përfaqëson një histori të tërë kulturore

andaj për ta ruajtur atë duhet një angazhim i dyanshëm si prej institucioneve njëashtu edhe prej antarëve të diasporës.

“Duhet bërë unifikimi i ministrive shqiptare (Shqipëri dhe Kosovë) si dhe gjuha duhet të certifikohet në vlerësim me kornizën e gjuhëve evropiane. Nivelit akademik duhet t'i kushtohet më shumë rëndësi, në mënyrë që gjuha shqipe të njihet si një gjuhë e një nivelit shkencor dhe jo vetëm si gjuhë e lashtë”.

“Të bëhet digjitalizmi i mësimit plotësues, duke ndjekur ligjeratat në një platformë interaktive online”.

“Duhet bërë marrëveshje bilaterale me kantonet në Zvicër që gjuha shqipe të futet si lëndë zgjedhore”.

“Themelimi i një biblioteke ku fëmijët dhe prindërit do kenë mundësinë të lexojnë libra në gjuhën shqipe”.

“Librat për mësimin plotësues të ofrohen falas dhe mësimdhënësit të paguhet nga shteti Kosovës. Në anën tjetër, të lansohen fushtat për vetëdijesimin e prindërve se si të ju mësojnë fëmijëve të tyre gjuhën shqipe, sa e rëndësishme është mësimi i gjuhës së origjinës për mësimin e gjuhës së vendit ku jetojnë”.

Përfaqësimi i diasporës dhe shkëmbimi i përvojave

Roli dhe potenciali i diasporës është duke marrë çdo ditë e më shumë vëmendje nga politikëbërësit, hulumtuesit dhe publiku dhe më shumë hapësirë në strategjitë zhvillimore të vendeve të ndryshme. Krijimi i lidhjeve në mes të anëtarëve të diasporës dhe institucioneve të vendit të origjinës është proces që kërkon angazhim dhe përkushtim të veçantë. Mënyra e qasjes ndaj një procesi të tillë është përcaktuese e nivelit të angazhimit dhe përfshirjes së diasporës në institucionet e shtetit dhe proceset tjera shoqërore të vendit të prejardhjes.

“Diaspora nuk duhet të ketë përfaqësues në Kuvend mirëpo të ketë përfaqësues të diasporës në komisione të ndryshme parlamentare, komunale etj”.

“Të bëhet një regjistër i profesionistëve të diasporës, ku këta profesionistë lajmërohen për konferenca, debate të ndryshme”.

“Lidhja e marrëveshjeve ndër shtetërore me Zvicërn për shkëmbim të përvojave”.

Harmonizimi i dy dokumenteve (Projektligjit dhe Startegjisë)

Projektligji aktual ka disa nene të cilat kanë një qëllim të përbashkët si p.sh (Mbledhja e të dhënave) dhe këto duhet të strukturohen në një nen të përbashkët, i ndarë në pika të caktuara: *Mbledhja e të dhënave për bizneset, shoqatat, profesionistët;*

Projektligji i propozuar duhet të strukturohet dhe të ketë një hierarki të neneve, të cilat janë të qarta dhe nuk krijojnë konfuzione. P.sh tek pjesa statusi i pjesëtarit të diasporës.

Sfidat

Një ndër pengesat apo sfidat për anëtarët e diasporës që ishin prezent në takimin në Zvicër shohin mos koordinimin në mes të politikave shtetërore; si dhe në mes të Kosovës dhe shteteve ku jeton diaspora. Mungesa e kuadrove profesionale në Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike gjithashtu edhe në misionet diplomatike, paraqesin sfida në krijimin e urave bashkëpunuese.

Mungesa e promovimit të storieve pozitive dhe të profesionistëve shqiptarë, intelektualëve të diasporës në media, gjithashtu promovimi i bizneseve shihet si një sfidë nga ana e tyre.

Kërkesat

- Krijimi i një udhëzuesi duke informuar pjesëtarët e Diasporës që Projektligji dhe Projekt-Strategjia janë në fazën e konsultimeve. Përmes programeve të ndryshme, të dy dokumentet të paraqiten edhe vizualisht (infografikave, prezantimeve);
- Një kërkesë tjetër që erdhi nga anëtarët e diasporës ishte edhe arritja më herët e fletëvotimeve në kohën e zgjedhjeve;
- Të bëhen hulumtime mbi bizneset shqiptare në diasporë.

SHTOJCA:

1. Investimet strategjike

- Kur përmenden investimet strategjike atëherë mos të përmenden vetëm bizneset, por edhe profesionistët që jetojnë jashtë vendit amë, nëse qëllimi është tek bizneset atëherë le të emërohet kjo pjesë e ligjit si Investimet ekonomike;
- Krijimi i një zyre të veçantë për investime sikurse që është në Maqedoni, sepse diaspora mund të sjellë shumë investitorë potencial në vend;
- Të hyrat nga kartoni i gjelbër të kthehen në fond për investime (shkolla, fabrika, etj);
- Të bëhet një plan se si duhet kanalizuar të hollat e diasporës, psh. krijimi i një fondi investiv i cili nuk menaxhohet nga ministria, mirëpo ministria ndihmon në krijimin dhe promovimin e tij, ndërsa menaxhimi bëhet nga ndonjë bank.

2. Ruajtja e identitetit (mësimi plotësues, kultura, media)

- Të bëhet unifikimi i ministrive shqiptare (Shqipëri, Kosovë) dhe gjuha të certifikohet në kornizën e gjuhëve evropiane. Nivelit akademik duhet t'i kushtohet më shumë rëndësi në Kosovë që të njihet si një gjuhë e një niveli shkencor, pasi që njihet vetëm si gjuhë e lashtë;
- Mësimi i gjuhës shqipe online përmes Skype apo ndonjë kanali tjetër online, ku në fund nxënësit marrin një diplomë për ndjekjen e këtij mësimi, pra të bëhet digjitalizmi i mësimin plotësues;
- Unifikimi i gjuhës përmes marrëveshjeve me kantonet e Zvicrës që gjuha shqipe të futet si lëndë zgjedhore;
- Krijimi i një biblioteke ku nxënësit dhe prindërit lexojnë libra në gjuhën shqipe, ofrimi i librave për mësimin plotësues falas, mësimdhënësit të paguhet nga shteti Kosovës, promovim/aftësim i prindërve se si të ju mësojnë fëmijëve të tyre gjuhën shqipe;
- Krijimi i një kinemaje për shqiptarët ku të rinjtë takohen dhe kështu ruajnë edhe traditën dhe gjuhën;
- Vet-organizmi i shoqatave/organizatave në diasporë pa ndihmën e institucioneve shtetërore, përmes krijimit të një fondi të përbashkët nga këto organizata;
- Të caktohen kritere nga ministria për mësimdhënësit e gjuhës shqipe;
- Krijimi i më shumë emisioneve për diasporë; krijimi i një emisioni për vetëdijësim të prindërve për mësimin e gjuhës shqipe dhe rëndësinë e saj;
- Tek mësimi plotësues dhe kultura duhet të shihet se një pjesë e detyrës mbetet tek diaspora pasi që janë pjesëtarë të realitetit në vendet e tyre dhe të jenë ata shtytës të aktiviteteve.

3. Përfshirja e diasporës, shkëmbimi i përvojave

- Të ketë përfaqësues të diasporës në komisione të ndryshme parlamentare, kuvende komunale;

- Regjistri i profesionistëve të diasporës, ku këta profesionistë lajmërohen për konferenca, debate të ndryshme;
- Krijimi i marrëveshjeve ndërshtetërore për shkëmbim të përvojave.

4. Të tjera

- Të caktohet saktë dita e diasporës, sepse çdo muaj po realizohen aktivitete si dita e diasporës, java e diasporës;
- Krijimi i një udhëzuesi, idetë e ministrisë të paraqiten vizualisht si projektligji ashtu projekt-strategjia, si dhe aktivitetet tjera;
- Fletëvotimet gjatë zgjedhjeve në Kosovë të arrijnë më herët jo në ditën e zgjedhjeve;
- Të bëhet një hulumtim se sa biznese shqiptare janë në Zvicër, Gjermani, Austri, etj, sepse këto të dhëna mungojnë;
- Tek projekt-strategjia të bëhet thjeshtëzimi i terminologjisë. Tek kultura ka mungesë të aktiviteteve në strategji. Duhet të përfshihet edhe ministria e kulturës dhe të ndahen përgjegjësitë dhe mundësitë e bashkëpunimit.

Rreth Germin

Germin është organizatë joqeveritare që përdor teknologjinë dhe kanalet digjitale për të lidhur dhe angazhuar diasporën në avancimin e zhvillimit dhe demokratizimit të vendeve të tyre amë. Ne përpiqemi të eksplorojmë dhe përdorim kanalet e TIK-ut për të lehtësuar më mirë dhe fuqizuar lidhjet mes diasporës, qytetarëve dhe qeverive në Ballkanin Perëndimor. Germin drejtohet nga një grup i profesionistëve të diasporës duke filluar nga fusha e politikave publike, financave, informimit dhe teknologjisë, juridikut dhe edukimit, sigurisë dhe mbrojtjes. Germin ka një rrjet prej 150 profesionistësh dhe bashkëpunëtorëve me kohë të pjesshme, që aktualisht jetojnë në 24 shtete përfshirë Ballkanin, Evropën Perëndimore dhe Amerikën Veriore. Germin po ashtu ka një rrjet prej 242 organizatave partnere në Diasporë përfshirë Europën, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadanë, Azinë dhe Australinë.

Angazhimi i Diasporës për Zhvillimin e Politikave është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).